

MILVA EKONOMI



Datëlindja: 31.12.1962

Vendlindja: Tiranë

Email: Milva.Ekonomi@parlameri.al

Jetëshkrimi:

Milva Ekonomi ka kryer studimet e larta në Statistikë dhe Ekonomi nga Universiteti i Bujqësor, dhe Master në Administrim Biznesi (MBA) nga Universiteti i Tiranës.

Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë në trajnime të avancuara në fushën e statistikave ekonomike dhe sociale si dhe të manaxhimit në Byronë e Statistikave të Punës (SHBA), Eurostat (Luxemburg), Istat (Itali). Ka qenë lektore në Universitetin e Tiranës, Universitetin Bujqësor, si dhe në Universitetin “Zonja e Këshillit të Mirë”. Ajo ka shkruar disa botime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e statistikave, zhvillimit social dhe ekonomik, si dhe të përkatësisë gjinore. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe italiane, si dhe njeh gjuhën franceze.

Znj. Ekonomi ka shërbyer si Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave të Shqipërisë gjatë periudhës 1994-2005, duke kryer një sërë detyrash që lidheshin me ngritjen dhe institucionalizimin e statistikave zyrtare në vend. Ka kryesuar Komisionin Kombëtar të Nomenklaturave dhe ka qenë për dy mandate anëtare e Byrosë së Konferencës së Statisticienëve Evropianë KEE/OKB.

Në vitin mars 2006, ajo zgjidhet anëtare e panelit të ekspertëve të projektit “PARIS 21” (OECD), ku punon mbi lidhjen e statistikave zyrtare me të drejtat e njeriut. Punon në këtë projekt deri në fund të dhjetorit 2007.

Më pas, ajo u përfshi si ekspert kyç në Agjencinë Evropiane për Rindërtim (EAR) në Kosovë, në projektin mbi Mbështetjen në Sistemin Statistikor dhe Përgatitjen e Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë 2007–2008.

Znj. Ekonomi dha kontributin e saj si Këshilltar Afatgjatë i Statistikave Suedeze (Sida) në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, ku punoi gjatë viteve 2008 – 2013, në hartimin e

legjislacionit statistikor dhe ndërtimin e Programit Zyrtar të Statistikave Kombëtare. Ajo gjithashtu ka punuar në projekte të ndryshme me agjencitë e OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare si Eurostat, ILO, UNODC, World Bank, Dfid, dhe FMN.

Ajo është anëtare e Institutit Ndërkombëtar të Statistikave (ISI) dhe Shoqatës së Statisticianëve të Ballkanit. Ajo është një nga themelueset e Institutit Agenda, një qendër kërkimesh ekonomike dhe sociale, e themeluar në qershor të vitit 2006 në Tiranë. Përgjatë viteve, ajo ka dhënë kontributin e saj në lëvizjen e gruas në Shqipëri, duke qenë aktiviste në shumë nisma, por gjithashtu edhe në aksione të shoqërisë civile.

Ajo ka shërbyer edhe si anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës për periudhën 2000-2011.

Znj. Ekonomi ka qenë zëvendësministre e Shëndetësisë (2013-2016). Në shkurt 2016 ajo u emërua në pozicionin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Prej janarit 2020 ajo ka mbajtur postin si kryetare e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Në dhjetor 2020 deri në shtator znj. Milva Ekonomi ushtroi detyrën e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.